

PROCEDURAT QË NDIQEN PAS NJË ABUZIMI SEKSUAL

1. Kur ndaj jush është kryer apo është tentuar të kryhet një krim seksual, punonjësi i policisë do të marrë denoncimin tuaj me shkrim;
2. Bashkë me ju duhet të jetë i pranishëm një i afërm apo një pjestar i familjes. Personi, që ju shoqëron nuk duhet të jetë dëshmitar i ngjarjes suaj;
3. Ju keni të drejtë të bëni edhe denoncime të tjera më vonë nëse mendoni që ka fakte të reja të cilat nuk keni arritur ose nuk ju janë kujtuar më parë;
4. Ju keni të drejtë të merrni një kopje të denoncimit. Nëse nuk është e mundur për momentin, kërkojeni atë në një fazë të mëvonëshme;
5. Nëse e keni të vështirë të shprehni lirëshëm në gjuhën shqipe, ju mund ta bëni denoncimin në gjuhën tuaj amëtare, por ai duhet përkthyer në gjuhën shqipe e duhet firmuar prej jush se përkthimi përputhet plotësisht me tuajin;
6. Punonjësi i policisë që ngarkohet me çështjen tuaj mund t'ju kërkojë të shkoni me të në qendrën e mjekësisë ligjore për të kryer egzaminimet e nevojshme për të hartuar raportin mjekoligjor;
7. Punonjësi i policisë do t'ju tregojë numurin e çështjes suaj. Shkruajeni sepse do t'ju duhet në rast se hetimi i çështjes do të vazhdojë me seanca të tjera pyetjesh dhe dëshmitarësh;
8. Njoftoni punonjësin e policisë për çdo ndryshim të adresës dhe të numurit të telefonit tuaj;
9. Punonjësi i policisë do t'ju informojë për çdo zhvillim të ri të çështjes suaj psh:
 - Ndalimi i të dyshuarit për krimin e kryer;
 - Hetimi i të dyshuarit në gjëndje të lirë;
 - Identifikimi apo njohjeje;
 - Datën kur do të zhvillohet gjyqi;
 - Kur duhet të paraqiteni për të dëshmuar
10. Punonjësi i policisë që heton çështjen tuaj do të mbledhë të gjithë informacionin e nevojshëm rreth çështjes. Në momentin që çështja do të shkojë për t'u gjykuar, ju do t'ju caktohet një avokat nga shteti (nëse nuk keni mundësi financiare të merrni avokatin tuaj) dhe një prokuror që do t'ju mbrojnë në gjyq. Këto shërbime janë papagesë. Ju dhe avokati i juaj mund të kërkonin informacione nga punonjësi i policisë gjyqësore apo nga prokurori kur çështja është çuar për gjykim.

Ju mund t'i telefononi në çdo kohë punonjësit të policisë nëse keni pyetje e paqartësi rreth problemit tuaj!

Ç' MUND TË NDJENI PAS NJË ABUZIMI APO NJË ABUZIMI SEKSUAL

- ◆ **Mbani mend!** Në çdo kohë dhe në çdo rast është dikush që mund t'ju ndihmojë – një mik, një pjestar i familjes, një psikolog, një mësues, një specialist i policisë, punëdhënësi i juaj etj.
- ◆ Çdo femër reagon në mënyrë të ndryshme ndaj një përdhunimi apo një abuzimi seksual – megjithatë ndjenja juaj është e natyrshme dhe e justifikueshme.
 - Ju mund të ndjeheni e pisët dhe doni të laheni në çdo moment e vazhdimisht;
 - Ju mund të ndjeheni e njollosur dhe e braktisur dhe keni frikë të dilni jashtë shtëpisë;
 - Ju mund të ndëshkoni që nuk arritët dot të mbroheshit dhe ndjeheni fajtorë;
 - Ju mund të ndjeni se duhet të hakmerreni dhe mund të nxisni dikë që t'ju ndihmojë ta realizoni këtë;
 - Ju mund të dëshironi të vazhdoni të bëni jetën tuaj normale dhe dëshironi ta harroni sa më parë që të jetë e mundur dëmin që pësuar;
 - Ju mund të vuani nga ëndëra të frikëshme, nga probleme të ushqimit apo të gjumit. Ju mund të qani shumë dhe të keni probleme në marrëdhëniet me miqtë dhe të afërmit tuaj.

Këto nuk janë ndjenja e reagime të panatyrshme, por eksperiencia e shumë njerëzve që kanë provuar abuzime seksuale apo që janë detyruar të shndrohen në prostituta duke i keqtrajtuar dhe abuzuar seksualisht me to.

- ◆ **Mbani mend!**
Abuzimi dhe përdhunimi nuk janë faji i juaj.

Njerëz dhe organizata në komunitetin tuaj që mund t'ju ndihmojnë:

- Punonjësit e Policisë së Shtetit
- Punonjësit socialë/mamitë e klinikës, spitali gjinekologjik
- Mjeku i familjes suaj
- Mësuesit tuaj kujdestarë apo psikologët e shkollës
- Kleriku i besimit tuaj
- Specialistet e qendrës juridike për këshillimin e gruas
- Qëndrat e trajtimit të traumave psikike dhe të rehabilitimit

Abuzimi seksual përfshin detyrimin për marrëdhënie seksuale në gjëndje pavetëdije (për shkak të alkoolit, drogës, paaftësisë mendore e fizike, të moshës); prekje të padëshirueshme seksuale ose detyrim me forcë për të kryer marrëdhënie poshtëruese.

Mbani mend! Askush nuk ka të drejtë të detyrojë dikë, të rritur apo të mitur, të përfshihet në veprime seksuale jashtë natyrës së këtyre marrëdhënieve

Mbrojtje Shërbim Siguri


- Parandalimi



- Denoncimi në polici



- Procedurat që ndiqen



Tel. nr. 129

TË THYEJTMË HESHTJEN
TË NDRYSHOJTMË SËBASHTKU

Gratë ose fëmijet viktimë të një abuzimi apo përdhunimi shpesh ndjehen të vrarë shpiurtërisht e konfuzë dhe nuk dinë ku të drejtohen e kujt t'i drejtohen për ndihmë.

Kjo fletëpalosje synon të japë informacion:

- Si të parandalohet rënia viktimë e një përdhunimi, rrëmbimi apo sulmi seksual;
- Çfarë ndodh kur raportohet një rast përdhunimi, rrëmbimi apo sulmi seksual në polici
- Ku mund të gjendet dhe të merret ndihma e nevojshme.

PARANDALIMI I SHËNDRIMIT NË VIKTIMË TË NJË RRËMBIMI APO TË NJË SULMI:

NË RRUGË

- Shmangni lëvizjet në vende e rrugë të pandriçuara, pa qarkullim, në kohë dhe rrethana që rrisin rrezikun;
- Ecni duke treguar se jeni të sigurt në vetvete dhe me një pamje të qetë – përdhunuesit prirën të sulmojnë ato që duken të pambrojtura dhe të frikësuara;
- Nëse mendoni se dikush po ju ndjek apo vini re se keni tërhequr vëmendjen e një personi të panjohur, ecni përherë në rrugë e vende me njerëz apo hyni në dyqan;
- Ecni nga ana e rrugës nëpër kthesa, larg qosheve të mureve e në krahun që makinat nuk vijnë nga mbrapa;
- Kur ngisni makinën vëzhgoni me kujdes në anët dhe horizontin e rrugës;
- Mbani përherë të mbyllura dyert e dritaret e makinës;
- Bëni kujdes ndaj personave që nuk i njihni, kur parkoni makinën, kur zbrisni nga autobuzi, nga taksia apo mjete të tjera të shërbimit urban;
- Asnjëherë mos udhëtoni nga një vend në tjetrin duke marrë çdo automjet apo motor që kalon;
- Asnjëherë mos merrni në makinë udhëtarë të rastit;
- Mos ndaloni asnjëherë pranë automjeteve apo njerzve të panjohura qoftë kur jeni duke udhëtuar me makinë, qoftë kur jeni duke u kthyer me këmbë për në shtëpi;
- Bëni kujdes rreth jush kur ndaloni për nevojat tuaja në rrugë apo pranë vitrinave të një dyqani;
- Mbani gjithmonë me vete një mjet sinjalizimi që tërheq vëmendjen e të tjerëve për ndihmë kur ndjeni rrezik apo kur sulmoheni;



NË SHTËPI

- Asnjëherë mos lejoni të huaj apo të panjohur të hyjnë në shtëpi – kur ju thonë se vijnë nga elektriku, për kontroll telefoni apo shërbime të tjera publike, madje edhe si punonjës të policisë. Sigurohuni që të jetë e vërtetë. Secili nga këto shërbime vjen nëse i kërkon për të riparuar difekte apo për kontrolle të autorizuara me grupe. Punonjësit e policisë vijnë gjithmonë me grupe dhe asnjëherë pa dokumenta zyrtarë kontrolli;
- Investoni për një bravë të sigurtë dhe një ganxhë që lejon hapje të pjesëshme të derës;
- Investoni për ta pajisur derën e shtëpisë me sy magjik që lejon të shikoni kush është pa hapur derën.
- Kujdesuni që ju ose fëmijët tuaj të mos tregojnë asnjëherë, përmes telefonit ose personit që ndodhet tek dera juaj, se jeni vetëm në shtëpi;
- Bashkëbisedoni me fqinjët tuaj, me stacionin tuaj të policisë dhe me njerëz që u besoni për masat paraprake që duhet të ndërmerri bashkarisht, për tu ndjerë më të sigurtë në shtëpinë apo në zonën tuaj të banimit.



**PERDHUNIMI
Ç duhet të dimë?**

- *Një përdhunim apo një tentativë për t'ju rrëmbyer është një abuzim seksual ndaj një partneri, nga një tjetër në një marrëdhënie të dhënë.*
 - *Mos lejoni asnjë person tjetër që t'ju prekë në atë mënyrë që ju të mund të ndjeheni në pozitë të vështirë apo të sikletëshme – duke ju drejtuar personit, i bëni të qartë se sjellja e tij është e papranueshme. Mosreagimi mund të keqkuptohet si miratim i heshtur dhe e inkurajon të vijojë më tej.*
 - *Mos lini takime e mos hyni në biseda shoqërore me dikë që sapo e keni njohur apo që nuk e njihni.*
 - *Ju keni të drejtën të pamohueshme të thoni "JO"*
- Mos harroni!** Mjaft gra dhe vajza kanë rënë viktimë e përdhunimeve, e rrëmbimeve kriminale, e abuzimeve seksuale nga dikush që e kanë njohur!



Ç'MUND TË BËNI KUR JU SULMOJNË ?

- ☞ Të mbash vetkontrollin, është mbrojtja juaj më e mirë;
- ☞ Mendoni – "jo panik" – qëndroni gjakftohtë;
- ☞ Bëhuni realiste për aftësitë tuaja për t'u vetmbrojtur;
- ☞ Nëse ndjeheni e kërcënuar ose e frikësuar – lëshoni një piskamë të fortë, bërtitni ose vraponi për në një vend të sigurtë nëse është e mundur;
- ☞ Qëllimi i juaj më kryesor është të mbeteni gjallë dhe e pacënuar nga sulmi;
- ☞ Reagoni shpejt e me vendosmëri nëse keni mundësi;
- ☞ Nëse mendoni që sulmuesi është i rrezikshëm: bashkëpunoni nëse rezistenca do t'ju kërcënonte jetën, ose përpiquni të negocioni me sulmuesin për ta bindur të heqë dorë nga qëllimi;
- ☞ Përpiquni të mbani mend shenja të dobishme për të identifikuar atë që ju sulmoi – moshën – racën - peshën apo gjatësinë - ngjyrën e flokëve apo të syve - nishanet apo çikatriçet – tatuazhet – veshjen - theksin e të folurit - zbulimet apo bizhuteritë që mund të ketë etj;
- ☞ Ruajini provat që mund të çojnë në identifikimin dhe vërtetimin e fajësisë të atij që ju ka sulmuar: një tufë flokësh; një send që mund t'i ketë rënë gjatë sulmit apo që ju mund t'ja keni shkëputur gjatë reagimit tuaj vetmbrojtës – Mos u lani dhe mos ndroni veshjen përderisa të mos jeni kqyruar nga specialistët e policisë për t'i fiksuar si provat e gjalla e të drejtëpërdrejta të sulmit që ju është bërë.
- ☞ Informoni dhe raportoni për krimin që ju është bërë në numurin e urgjencës **129**, ose shkoni vetë në komisariatin e policisë për të denoncuar krimin.



Policia e Shtetit është e ngarkuar nga Kushtetuta e Shqipërisë dhe nga Ligji, që t'ju ndihmojë me ekspertë dhe me shërbime të specializuara të parandalimit e zbulimit të krimeve kundër personit.

Për të kontaktuar në çdo kohë:
Komisariati i policisë _____
Punonjësi i policisë gjyqësore _____
Telefon Nr. _____
Inspektori i zonës _____
Data e njoftimit _____